


UNIVERSITETI MESDHETAR

# HAPEN APLIKIMET PËR PROGRAMET DOKTORALE PRANË **FAKULTETIT TË SHKENCA EKONOMIKE** DHE **FAKULTETIT TË INFORMATIKËS** PËR VITIN 2024.

Afati i aplikimeve është deri në datën 21 Janar 2024.

UNIVERSITETI MESDHETAR

# Kriteret e përgjithshme të aplikimit në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në **“Shkenca Ekonomike” dhe “Informatikë”**

1. Aplikanti pranohet në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 78, dhe neni 79);
2. Të ketë përfunduar dhe zotërojë diplomë të Studimeve të Larta Universitare;
3. Të ketë përfunduar dhe zotërojë një diplomë Master i Shkencave/Master i arteve ose ekuivalente me të;
4. Diplomat e fituara në një nga Institucionet e Arsimit të lartë jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jetë e ekulivalentuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.
5. Aplikanti duhet të ketë njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në nivelin C1 apo ekuivalenti i këtij niveli , të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se dy vjet nga koha e lëshimit të tyre në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3. Aplikantët që kanë fituar një diplomë pas përfundimit të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e mësipërme, diploma e fituar dhe e njësuar nga ministria përkatëse shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së këtij kriteri;
6. Aplikanti mund të jetë edhe bashkëpunëtor i brendshëm/i jashtëm në një Institucion të Arsimit të Lartë, institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
7. Aplikanti duhet të hartojë një Projekt Propozim i cili duhet të ketë në qendër fushën e përzgjedhur ku do të kryejë kërkimin.

1 *Referoju Listës së niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testimeve ndërkombëtare në reference të përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015.*

1 *Referoju Listës së niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testimeve ndërkombëtare në reference të përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015.*

# FUSHAT ME INTERES KËRKIMOR

## FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE

| Grup fusha | Akset e kërkimit |
|---|---|
| Financë dhe Qeverisje Korporatash | -Optimizimi i kostove të kapitalit nëpërmjet përmirësimit të strukturës së financimit të korporatës;<br>-Menaxhimi i parave, investimeve dhe instrumenteve të tjera financiare në korporatë;<br>-Maksimizimi i vlerës së aksioneve nëpërmjet strukturës optimale të kapitalit;<br>-Qeverisja e korporatave si një standart thelbësor për krijimin e një mjedisi të mirë investimi dhe konkurrence;<br>-Rëndësia e qeverisjes së korporatave në ndarjen e menaxhmentit dhe kontrollit nga pronësia;<br>-Struktura e qeverisjes së korporatës dhe ndikimi i saj në vendimet e financimit, investimit dhe në efikasitetin e prodhimit. |
| Politikat e Tregjeve dhe Institucioneve Ekonomike dhe Financiare | - Mekanizmat klasikë dhe modernë në revolucionin e tregjeve të kapitalit;<br>-Institucionet financiare dhe përballja me rrezikun e kredisë, normave të interesit, kursit të këmbimit dhe likuiditetit;<br>-Institucionet, tregjet dhe instrumentat financiare, si domosdoshmëri në gjetjen e formave të reja të financimit dhe likuiditetit;<br>-Politikat e financimit nëpërmjet titujve financiare të projekteve publike;<br>-Risitë e tregjeve financiare dhe paqyrim i drejtëpërdrejtë i efekteve të globalizimit dhe proceseve derregulluese;<br>-Reagimet dhe vendimet e aktorëve ekonomikë në tregjet financiare ndaj një mjedisi të pasigurt në tregjet e tjera;<br>-Politikat financiare që lidhen me rregullimin, dhe mbikqyrjen e sistemeve financiare;<br>-Politikat në funksion të stabilitetit financiar, efikasitetin e tregut dhe mbrojtjen e investitorëve. |
| Rritja ekonomike dhe zhvillimi i qendrueshëm | -Analiza dhe vlerësimi i politikave publike në ekonomi,me fokus në politikat e zhvillimit të qëndrueshëm, politikat fiskale, politikat monetare.<br><br>-Thellimi në njohjen dhe analizën e formave të reja të konkurrencës për të evidentuar rolin e tyre në ekonomi (Entet publike, PPP, Koncensionet etj).<br><br>-Analiza dinamike e kapitalit njerëzor dhe impakti i tij në rritjen ekonomike në këndvështrimin afatgjatë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. |
| Informacioni dhe format e reja të marketingut | -Nevoja e organizatave në krijimin dhe adoptimin e strategjive të reja të marketingut dhe atij digjital.<br>-Zinxhiri i vlerës së produkteve lokale, roli i logjistikës dhe kanaleve të shpërndarjes në vlerën e shtuar.<br>-Siguria e tregjeve, në funksion të nxitjes së zhvillimit të qendrueshëm të vendit në nje treg të hapur dhe global.<br>-Politikat e marketingut modern dhe imazhit të tij në tregje.<br>-Revolucioni digjital dhe roli i inovacionit financiar në stimulimin e kërkesës së tregut për produkte. |

| | |
|---|---|
| **Vendimmarrja dhe strategjitë inovative** | - Njohja e nevoja te organizatave për strategji të reja të marketingut, atij digjital në vecanti, dhe mbështetja për krijimin ose përshtatjen e tyre në kushtet aktuale.<br><br>- Përdorimi me efektivitet i rrjeteve sociale në marketingun digjital duke përfshirë instrumente të reja me kosto efektive. |
| **Menaxhimi i burimeve natyrore përballë ndryshimeve ekonomike dhe mjedisore** | -Kryerja e vëzhgimeve dhe analizave mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike mjedisore në ekonomi në nivel lokal dhe rajonal. Cilat janë sfidat e menaxhimit të burimeve natyrore në këto kushte.<br><br>-Vëzhgim mbi sistemet dhe strategjitë e prodhimit lokal për të orientuar rritjen e vlerës së burimeve natyrore kombëtare.<br><br>-Analiza dhe rekomandime mbi zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Shqipëri, me impakt në ekonomi dhe punësimin lokal. |

# FAKULTETI I INFORMATIKËS

| | |
|---|---|
| **Aplikimet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në ekonomi** | -Machine Learning dhe Artificial Intelligence, si mjete që mund të përdoren nga bizneset dhe sektorë të tjerë të ekonomisë për të rritur efiçencën dhe produktivitetin.<br>-Studimi i sjelljes së klientëve dhe rritja e kënaqësisë së tyre nëpërmjet teknologjisë së Artificial Intelligence dhe Machine Learning<br>-Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit nëpërmjet teknologjisë Blockchain, për një menaxhim të mirë të të dhënave dhe transparencë duke filluar nga bërja e porosisë, blerja, kthimi dhe marrja e produktit.<br>-Rritja e sigurisë kibernetike, si mjet për të mbrojtur veprimtarinë e biznesit nga sulmet e jashtme dhe aksesi i paautorizuar.<br>- Shëndeti Digjital si një mundësi për pacientët për të marrë kujdesin e duhur shëndetësor pa vizitë personale dhe kryerjen e ekzaminimeve të vazhdueshme mjekësore në distancë.<br>- IoB (Internet of Behaviors) Interneti i sjelljeve ofron më shumë qartësi për bizneset lidhur me sjelljen e konsumatorëve duke mbledhur dhe analizuar të dhëna në lidhje me ndërveprimet e konsumatorëve, preferencat dhe sjelljen blerëse.<br>-Teknologjia me kod të ulët (Low-code technology)<br>Teknologjia me kod të ulët i mundëson bizneseve zgjidhjen e një sërë sfidave pa qenë nevoja e angazhimit të burimeve teknike me kualifikim të lartë.<br>- Informatika kuantike e cila ju ofron bizneseve një mjet të fuqishëm për analiza parashikuese dhe analiza të big data duke i ndihmuar ata në parashikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.<br>- Automatizimi i procesit duke përdorur robotët. Automatizimi i detyrave duke përdorur robotë në vend të punës njerëzore si një mënyrë për të ndihmuar bizneset në përballimin efikas të flukseve të punës.<br>- Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në menaxhimin e projekteve, rrit të ardhurat e biznesit, rrit transparencën si dhe përmirëson komunikimin mes punonjësve.<br>-Trajton drejtime të, Cloud Computing, Data Warehouse Management dhe IT project Management, inteligjences artificiale, robotikes, etj.<br>- Studimi i algoritmeve të avancuara per kuptimin e gjuhes natyrore (studime mbi proceset zgjedhore, marketingut, fenomeneve ekonomike e sociale, etj.)<br>- Ndërtimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për automatizimin e proceseve të biznesit. |

# DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Aplikantët duhet të dorëzojnë pranë Shkollës Doktorale të UMSH dosjen me dokumentacionin e kërkuar dorazi ose me postë duke filluar nga data 13.12.2023 deri në datë 20.01.2024.

1. Dosja duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:
   a. Kërkesë personale drejtuar njësisë bazë/kryesore, përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të ciklit të tretë;
   b. CV personale në formatin europass, ku të evidentohet edhe lista e punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit (në rastin kur personi që aplikon ka të tilla);
   c. Kopje të noterizuara të diplomës universitare, kopje të noterizuar të diplomës “Master i shkencave” si dhe kopje të noterizuar të listës së notave për të gjitha nivelet e studimeve/diplomave, ose çdo dokument i ekuivalentuar me të nga institucioni përkatës i shtetit shqiptar (kopje e noterizuar).
   d. Dëshmi origjinale ose të noterizuar të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja në nivelin C1 apo ekuivalenti i këtij niveli (përkatësisht gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane ose gjuhës spanjolle). Dokumeti i njohjes së gjuhës së huaj mund të jetë një çertifikatë, diplomë ose dëshmi e lëshuar nga subjekti të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testimeve ndërkombëtare, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se dy vjet nga koha e lëshimit të tyre;
   e. Dy rekomandime të bëra nga studiues ose drejtues të njohur në shkallë kombëtare ose ndërkombetare që i përkasin kategorisë Profesor ose studiues të huaj me gradën PhD të fituar në një nga vendet e OECD-së.Vërtetim nëse ka që është bashkëpunëtor i brendshëm ose i jashtëm në një Institucion të Arsimit të Lartë ose institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar
   f. Fotokopje e ID ose pasaportës;
   g. Dy fotografi;
   h. Një propozim jo më pak se 4000 fjalë për fushën dhe problemin që do të studiojë në përputhje me Aneksin 1[2] ;
   i. Vetëdeklarim që kundrejt tij nuk janë marrë masa disiplinore, nuk janë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës dhe se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
   j. Çdo dokument që aplikanti e konsideron të domosdoshëm për të evidentuar ose vertëtuar aftësitë e tij.
2. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurim në vlerën 5000 (pesë mijë) lekë.
3. Dokumentet e dorëzuara gjatë këtij aplikimi, nuk mund të tërhiqen nga aplikanti, por arkivohen në institucion.

Për informacion më të detajuar lidhur me kriteret specifike, procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe pranimit referojuni njësisë kryesore që ofron fushën e studimit duke vizituar faqen web të Institucionit: https://www.umsh.edu.al/

2 Aneksi 1: Formatprojekt propozim në pwrputhje me fushat e kërkimit.

# Aneksi 1: Format Projekt Propozim në përputhje me fushat e kërkimit

**PROJEKT PROPOZIMI KËRKIMOR SHKENCOR PËR DOKTORATË**

1. Fusha e përzgjedhur e kërkimit nga fushat e miratuara të kërkimit të FSHE- s dhe udhëheqësi shkencor i propozuar (një nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë profesor në FSHE).
2. **Projekt Propozimi** nuk duhet të jetë më pak se 4000 fjalë për fushën dhe problemin e studimit.
3. **Abstrakt** (200 – 300 fjalë, në shqip dhe anglisht).
4. **Përshkrimi i situatës aktuale** (Përshkruani situatën aktuale të fushës kërkimore, konteksti dhe arsyetimi që justifikon ndërmarrjen e këtij projekt propozimi, deri në 500 fjalë).
5. **Pyetja/pyetjet kërkimore dhe objektivat e kërkimit** (Evidentoni qartë pyetjen/pyetjet kërkimore dhe listoni objektivat e kërkimit).
6. **Rishikimi i literaturës** (Max 1 faqe).
7. **Metodologjia e kërkimit të projekt propozimit** (Përshkrimi i detajuar i metodologjisë së kërkimit shkencor).
8. **Rezultatet e pritura të projekt propozimit** (Rezultatet të lidhura me objektivat e kërkimit).
9. **Planifikimi kohor**
10. **Referenca**



**Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë**
Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52,
Kodi Postar: 1023, Tiranë

**Tel:** +355 (4) 2421774
**Cel:** +355 68 50 47301
**Email:** info@umsh.edu.al

**Rrjetet tona sociale**
**Fb:** Universiteti Mesdhetar i Shqiperise
**In:** @universitetimesdhetar